



Promovojmë  
Transparencën

Mbrojmë  
të Dhënat  
Personale

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

15 VJET

15 VJET ZYRA E KOMISIONERIT

KONFERENCA V KOMBËTARE

“E DREJTA PËR INFORMIM  
HAPJE, TRANSPARENCË, DIGJITALIZIM”



INFORMATION AND  
DATA PROTECTION  
COMMISSIONER





Të dhënat e hapura mbështesin dhe inkurajojnë novacionin dhe rrisin përgjegjshmërinë, duke përmirësuar demokracinë.



Shqipëria është pjesë e Nismës Globale të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP)



Vendim KM nr. 147 datë 18.2.2015 “Për miratimin e një dokumenti politikash për zbatimin e të dhënave të hapura publike dhe krijimin e një portali të të dhënave të hapura”  
**Opendata.al**



Ligji nr. 33/2022, datë 31.03.2022, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.

Ligji nr. 33/2022, datë 31.03.2022, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”

Përcakton rregullat dhe procedurat për të drejtën e ripërdorimit të të dhënave të hapura për qëllime fitimi ose jo të dokumenteve që mbahen nga organet e sektorit publik ose sipërmarrjet publike në Republikën e Shqipërisë.

Organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike vënë në dispozicion një dokument në formatin e gjuhën që zotërohet, në datën e kërkesës për ripërdorim e, kur është e mundur dhe e përshtatshme, përmes mjeteve elektronike në format të hapur, të lexueshëm nga kompjuterët, të aksesueshëm dhe të ripërdorshëm, së bashku me metadatat e tij.

Me qëllim lehtësimin e kërkimit të të dhënave të hapura të ofruara nga organet e sektorit publik, krijohet/funksionon portali i të dhënave të hapura qeveritare. Me vendim të Këshillit të Ministrave miratohen rregulla praktike për lehtësimin e kërkimit të të dhënave të hapura.

# KOMPETENÇAT E KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është përgjegjës për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e së drejtës për ripërdorim të dokumenteve sipas këtij ligji.

Organet e sektorit publik duhet të bashkëpunojnë me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duke i dhënë të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave të tij të përcaktuara në këtë ligj.

Nëse palët e interesuara vlerësojnë se organi i sektorit publik ose sipërmarrja publike ka cenuar të drejtën e tyre për ripërdorim të dokumenteve sipas parashikimeve të këtij ligji, ato kanë të drejtë të ankohen në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale